VENDIM
Nr. 356, datë 26.5.2022

PËR PËRCAKTIMIN E ORGANIZATAVE TË PUNËDHËNËSVE DHE TË ORGANIZATAVE SINDIKALE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 200, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizatat e punëdhënësve dhe organizatat sindikale, anëtarë të Këshillit Kombëtar të Punës, janë si më poshtë vijon:

A. Për organizatat e punëdhënësve:

a) Bashkimi i Bizneseve Shqiptare (BIZNES ALBANIA): 1 anëtar, 1 kandidat;

b) Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB): 1 anëtar, 1 kandidat;

c) Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (SHNSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ç) Shoqata Shqiptare e Turizmit (SHSHT): 1 anëtar, 1 kandidat;

d) Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS): 1 anëtar, 1 kandidat;

dh) Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH): 1 anëtar, 1 kandidat;

e) Bashkimi i Investitorëve dhe Industrialistëve Shqiptarë (BI&ISH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ë) Shoqata "Bashkimi i Prodhuesve Shqiptare" (SHBPSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

f) Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve/Këpucëve - Proeksport Albania (DHKPVPA): 1 anëtar, 1 kandidat;

g) Shoqata e Bukës Pastiçerisë dhe Brumërave (SHBPB): 1 anëtar, 1 kandidat.

B. Për organizatat sindikale:

a) Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

b) Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH): 1 anëtar, 1 kandidat;

c) Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë (SPMSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ç) Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Ndërtimit dhe Shërbimeve Publike të Shqipërisë (SPPNSHPSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

d) Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

dh) Federata e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FPISH): 1 anëtar, 1 kandidat;

e) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor (FSPSHSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ë) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Tekstileve, Konfeksioneve dhe Shërbimeve të Artizanatit të Shqipërisë (FSPTKSHASH): 1 anëtar, 1 kandidat;

f) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Shërbimeve Financiare, Tregtare, Bankare dhe Turizmit (FSPSHFTBTSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

g) Sindikata Autonome e Ushqimit, Agrikulturës, Tregtisë dhe Turizmit (SAUATT): 1 anëtar, 1 kandidat.

2. Emërimi i anëtarëve dhe i kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës bëhet nga ministri përgjegjës për punën, sipas propozimeve të organizatave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 129, datë 7.3.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve në Këshillin Kombëtar të Punës", shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama